



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-2915/12
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.	02	Data	16-08-2012
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.07.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4804/11, për z. **Fadil Osmani** – Kryesues i Bordit të Kompanisë Publike “Higjena” Gjilan, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4804-11, është inicuar për Zyrtarin e lartë, z. Fadil Osmani - Anëtar i Bordit të Kompanisë “Higjena”, dhe është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Por, në takimin e parë me ztr. Osmani kemi vërejtur se bëhet fjalë për një gabim material, sepse fjala ishte për një tjetër Fadil Osmani dhe emri i zyrtarit të lartë Fadil Osmani, Kryesues i Bordit të Kompanisë publike “Higjena” nuk ka të bëjë asgjë me personin që po ashtu quhet Fadil Osmani e që është pjesë e një biznesit privat.

Këtë dyshim e kemi verifikuar edhe në faqen e Agjencionit për regjistrimin e bizneseve nga e cila tani nuk na shfaqet asnjë biznes që menaxhohet nga zyrtari i lartë Fadil Osmani, por shfaqet një emër tjetër Fadil Osmani që është qytetar i rëndomt – jo zyrtar i lartë.

Në bazë të këtyre informacioneve të kompletuara, kemi konstatuar se rasti duhet të mbyllet me vendimin se nuk ka prova që dëshmojnë konfliktin e interesit të zyrtari Fadil Osmani – Kryesues i Bordit “Higjena”

Kjo gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Ligji Nr.04/L-051).

II. Çdo situatë tjetër e mundshme e paraqitjes “rast për rast” e konflikti të interesit (Neni 13, i Ligjit Nr. 04/L-051) nuk e përjashton nga përgjegjësia zyrtarin Fadil Osmani, dhe në të gjitha këto raste eventuale, ztr. Osmani obligohet të bëjë deklarinimin e interesave private.

Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Prëmem

